



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Metodologji e Mësimdhënies dhe të Menduarit Kritik

Ngarkesa: 7 kredite; 90 orë mësimore; 60 leksione / 30 seminare

Viti / Semestri : Viti I, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master i Shkencave në “Mësuesi e gjuhës italiane ”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nene 4, 6,7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Dallojnë metodat më kryesore të mësimdhënies. Klasifikojnë karakteristikat kryesore të metodave të mësimdhënies. Evidentojnë rezultatet e studimeve sipas përvojave të ndryshme. Zbatojnë modelet moderne të mësimdhënies në sistemin tonë arsimor. Gjykojnë në mënyrë të pavarur modelet ekzistuese. Kuptojnë përkufizimin e të menduarit kritik, rëndësia dhe përkufizimi i termave ‘sistematik’, ‘vlerësim’, ‘formulim’ dhe ‘kritere racionale’.

Objektivat specifike lëndore:

1. Tregojnë se pengesat më të zakonshme ndaj të menduarit kritik mund të grupohen në dy kategori: (1) pengesa që kanë shkak *mënyrën* se si mendojmë dhe (2) pengesa që kanë shkak *atë* që mendojmë.
2. Kuptojnë se kur një pretendim përplasat me pretendime të tjera, të cilat ne kemi arsye të mjaftueshme për t’i pranuar, atëherë kemi arsye të forta për ta vënë atë në dyshim.
3. Dallojnë se kur një pretendim vjen në kundërshtim me njohuritë tona themelore, kemi arsye të mjaftueshme për ta vënë në dyshim atë.

Rezultatet e pritshme:

1. Studenti është në gjendje të analizojë dhe të zbatojë në mënyrë të arsyetuar modelet dhe strategjitë bashkëkohore të mësimdhënies, duke marrë parasysh natyrën, evolucionin dhe kontekstin e tyre pedagogjik.
2. Studenti zhvillon aftësi për të zbatuar parimet e të menduarit kritik në planifikimin dhe realizimin e mësimdhënies, si dhe në vlerësimin e informacionit, argumenteve dhe teorive në mënyrë logjike dhe të bazuar në prova.
3. Studenti demonstroi kompetencë në përdorimin e metodave të të nxënimit aktiv dhe të aspekteve psikologjike të mësimdhënies, duke u fokusuar në lehtësimin e të nxënimit të gjithsecilit në klasë dhe në ndërtimin e një kurrikule efektive.